IC.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 1982 Prot. Lezhë, më 10 /02 /2026

**P/VENDIM**

**Nr._____.,datë 10/02 /2026**

**"PËR
MIRATIMIN E PRIORITETEVE DHE PROJEKTEVE PËR INVESTIME NË KUADËR TË PËRGATITJES SË PBA-SË 2027-2029 DHE TË BUXHETIT TË VITIT 2027"**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar; ligjit Nr. 9936., datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimit të MFE Nr. 23., datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësive të Qeverisjes Vendore", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 114., datë 15.12.2025 "Për Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe të Buxhetit vjetor 2027"; Kryetari i Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak;

**PËR TË VENDOSUR:**

1. Miratimin e prioriteve dhe projekteve për investime, në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe të Buxhetit të vitit 2027, sipas tabelës Nr. 1 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

**K R Y E T A R I**
**Pjerin Ndreu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 1882/1 Prot. Lezhë, më 10/02/2026

**MIRATOHET**
**KRYETARI**
**Pjerin Ndreu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

# RELACION

## "PËR
## MIRATIMIN E PRIORITETEVE DHE PROJEKTEVE PËR INVESTIME NË KUADËR TË PËRGATITJES SË PBA-së 2027-2029 DHE TË BUXHETIT TË VITIT 2027"

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar; ligjit Nr. 9936., datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimit të MFE Nr. 23., datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë Nr. 114., datë 15.12.2025 "Për Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027", pika 4 e pikes 1 të Vendimit, në të cilën ngarkohet Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës të "Përgatisë dhe të paraqesë në këshill për miratim, i prioriteteve dhe projekteve për investime e kostot e tyre. Qëllimi, objektivat dhe politikat sipas programeve, duke u adresuar edhe në respektimin e ligjit "Për barazinë gjinore".

Për këtë proces Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Trasparencës ka kërkuar informacion drejtuar të gjitha drejtorive në bashki në lidhje me prioritetet dhe projekteve për investime në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit Vjetor 2027, duke u mbështetur në dokumentat strategjike dhe nevojave sipas fushave përkatëse për secilën drejtori.

Pas mbledhjes së informacionit, grupi i punës është mbledhur dhe ka analizuar prioritetet për vitet 2027 dhe 2029 të cilat janë të miratuara aktualisht sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 114., datë 15.12.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Buxhetit për vitin 2027".

Në përfundim, pas analizimit të prioriteteve dhe projekteve të investimeve, grupi i punës miratoi listën e prioriteteve të investime për vitet 2027, 2028 dhe 2029, sipas listës Nr. 1 bashkëlidhur.

Nisur nga kjo, kërkojmë miratimin e prioriteve dhe projekteve për investime në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe Buxhetit të vitit 2027.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI**
**Vasilika Laska**

| PRIORITETET E INVESTIMEVE DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR VITET 2027-2029 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| NR | IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE KAPITALE | BURIMI I FINANCIMIT (I MUNDSHËM) | VLERA Ne lekë | 2027 | 2028 | 2029 |
| 1 | Digitalizimi i arkives | Bashkia Lezhë | 10,000,000 | | | 10,000,000 |
| 2 | Pershtatja e shkolles "Kosova" ne cerdhe publike nr 2 | Ministria /B.F Bashkia | 131,327,014 | 131,327,014 | | |
| | Ndertimi I Çerdhes publike ne Njesine Administrative Shenkoll | Ministria /B.F Bashkia | 200,000,000 | | | 200,000,000 |
| 3 | Rikonstruksion I shkolles 9-vjeçare "Shtjefen Gjeçovi"Troshan | Ministria /B.F Bashkia | 134,671,308 | 134,671,308 | | |
| | Rikonstruksion I Qendres Kulturore te Femijeve"Gjergj Lacaj" | Ministria /B.F Bashkia | 69,839,887 | | 69,839,887 | |
| | Objekt I ri 1-katesh dhe rinkostruksioni I objektit ekzistues te shkolles 9-vjecare"Dode Gege Jaku" Manati | Ministria /B.F Bashkia | 92,249,422 | | 92,249,422.02 | |
| | Ndertimi I shteses anesore dhe rikonstruksion I shkolles 9-vjeçare "Marash Gjoni" Rrilë | Ministria /B.F Bashkia | 288,623,501 | | | 288,623,501 |
| 4 | Rehabilitimi I kanalit te dyte ujites SV.17 | Bashkia Lezhë | 2,591,416 | | | 2,591,416 |
| | Rehabilitimi I kanalit te dyte ujites SV.18 | Bashkia Lezhë /Buxhet shteti | 14,169,947 | | | 14,169,947 |
| | Hartimi I planit te Mbareshtimit per ekonomine pyjore Mali I Kakarriqit | Bashkia Lezhë /Buxhet shteti | 5,662,956 | 5,662,956 | | |
| | Pyllezim me fidane pyjor ne ekonomine pyjore brinjat e Kreshtës ,Nj.Adm Ungrej | Bashkia Lezhë /Buxhet shteti | 29,013,153 | | | 29,013,153 |
| | Ndertim dhe rikonstruksion I pritave malore ne Nj.Adm Blinisht, Kolsh, Kallmet | Bashkia Lezhë /Buxhet shteti | 15,750,000 | 15,750,000 | | |
| 5 | Zgjerim dhe rehabilitim i rrjetit rrugor Rural me Asfalt+ rikualifikim sh | Bashkia Lezhë | 1,223,611,539 | 593,696,539 | 629,915,000 | |
| | Sistemim asfaltim rruga Qafa e Pazarit -Ura e Martenzës | | 64,532,061 | 64,532,061 | | |
| | Ndërtimi i lulishteve të reja (në qytetet Lezhë dhe Shëngjin) | | 92,931,898 | 42,931,898 | | 50,000,000 |
| | Rehabilitim i rrugëve Urbane me Asfalt dhe trotuareve | | 45,000,000 | | | 45,000,000 |
| | Ndërtimi i Varrezave të Reja të qytetit Lezhë | | 170,788,347 | 112,553,496 | 58,234,851 | |
| | Ndërtimi i Parkut në lagjen Nënë Tereza | | 51,499,301 | 51,499,301 | | |
| | Ndërtimi i Pedonales në rrugën Faik Konica | | 62,770,232 | 62,770,232 | | |
| | Korridori i gjelbert Lezhe-Shengjin eshte nje projekt strategjik qe synon ndertimin e nje infrastrukture moderrne biçikletash dhe mobilitetiti te qendrushem me gjatesi rreth 8km,qe lidh qytetin e Lezhes me zonen turistike te Shengjinit | | 220,000,000 | | | 220,000,000 |
| | Ndertimi i rruges dytesore Kune sipas PPV Urbanistik me gjatesi 1.6km | | 210,000,000 | | | 210,000,000 |
| | Ndertimi i 2 terminaleve Lezhë-Shengjin te transportit Publik dhe 16 stacioneve rurale te autobuzave ne territorin e Bashkise Lezhe | | 200,000,000 | | | 200,000,000 |
| | Ndertim i Ures qe lidh lagjen Gjenje me rrugen e Tabes. Me gjatesi 15 ml | | 5,000,000 | | | 5,000,000 |
| | Ndertim i Ures, nderlidhja e qytetit te Lezhes me hyrjen e qytetit | | 15,000,000 | | | 15,000,000 |
| | Ndertim Rruga e Veles | | 200,000,000 | | | 200,000,000 |
| | Rikualifikimi i trotuareve ne zonat rurale dhe urbane | | 100,000,000 | | | 100,000,000 |